

## Vendim nr. 293 datë 27.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 27.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (J) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** JANAQ KACELI

**OBJEKTI:** Kundërshtimi i vendimit nr. 00-2024-162, datë 25.01.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Në datën 26.02.2016, në pikën e kalimit kufitar Kapshticë, Korçë, në dalje, gjatë kontrollit fizik të një kamioni, që kishte për destinacion final Turqinë, shërbimet e Policisë Gjyqësore kanë gjetur dhe sekuestruar një sasi prej 574 kg lëndësh narkotike të llojit *cannabis sativa*, të ndarë në 474 pako dhe të fshehura në tavanin e karrocërisë së kamionit dhe të rimorkios, ndërsa është arrestuar në flagrancë drejtuesi i mjetit shtetasi E.Z., të cilit në vijim i janë sekuestruar edhe dy aparate telefoni celular. Po këtë ditë, i dyshuar si bashkëpunëtor në

veprën penale, është arrestuar në flagrancë edhe kërkuesi Janaq Kaceli, ndërsa po udhëtonte në drejtim të Korçës, të cilit në vijim i janë sekuestruar tre aparate telefoni celular. Për këtë ngjarje Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka regjistruar një procedim penal për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim dhe të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a, paragrafi 2 dhe 22 të Kodit Penal (KP). Në përfundim të hetimeve paraprake, kërkuesi është akuzuar për këtë vepër penale dhe çështja për të gjithë të pandehurit në atë procedim penal është dërguar për gjykim.

2. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, pasi ka dëgjuar kërkuesin, i cili ka kërkuar të procedohet me gjykim të zakonshëm, ka veçuar çështjen e tij nga ajo e të bashkëpandehurve të tjerë, për të cilët është proceduar me gjykim të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit të zakonshëm për kërkuesin, me vendimin nr. 121, datë 19.12.2017, ajo gjykatë ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim dhe të mbetur në tentativë, duke e dënuar me 12 vjet burgim. Sipas asaj gjykate, nga vlerësimi në tërësi dhe harmoni i provave të marra dhe të verifikuara në gjykim, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se vepra penale e trafikimit të narkotikëve është kryer me pjesëmarrjen e disa personave, përfshirë edhe të kërkuesit, të cilët kanë pasur marrëveshje paraprake për kryerjen e saj dhe secili prej tyre ka vepruar për arritjen e qëllimit të përbashkët, atij për eksportimin e lëndës narkotike nga Shqipëria drejt Turqisë, ku për sa i përket rolit të kërkuesit në bashkëpunim, më së paku ai ka vepruar në rolin e ndihmësit. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim, duke pretenduar, ndër të tjera, se nuk është provuar në gjykim fajësia e tij në kryerjen e veprës penale.

3. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 32, datë 09.03.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duke e gjetur atë në përputhje me provat dhe në zbatim të drejtë të ligjit. Edhe sipas gjykatës së apelit, nga analiza e provave të marra e të verifikuara në gjykim, krijohet bindja se kërkuesi ka bashkëpunuar/bashkëvepruar me të bashkëpandehurit e tjerë (dy prej të cilëve tashmë janë dënuar), me qëllim realizimin e trafikimit të lëndës narkotike, në formën e eksportimit të saj nga Shqipëria për në destinacionin final të saj, Turqi dhe se, në kundërshtim nga sa pretendon mbrojtja e kërkuesit, secili prej bashkëpunëtorëve në kryerjen e këtij trafikimi ka marrë përsipër kryerjen e një apo disa veprimeve në funksion të arritjes së qëllimit të përbashkët final, eksportimit në mënyrë të kundërligjshme të sasisë së lëndës narkotike, ku për sa i përket kërkuesit ai ka marrë pjesë aktive duke kontribuar në sigurimin e mjetit, të përshtatshëm për transportimin e lëndës narkotike, si dhe në ndihmën ndaj personit që do të kryente këtë transportim. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar rekurs.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-162, datë 25.01.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit, me arsyetimin se nga përmbajtja e vendimeve të gjykatave të shkallëve më të ulëta, tërësia e akteve të marra e të verifikuara në këtë proces penal, si dhe në verifikim të shkaqeve të rekursit, pretendimet e ngritura në themel të këtyre shkaqeve nuk integrohen në ato të parashikuara në nenin 432, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), për rrjedhojë nuk ka shkaqe për cenimin e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Sipas atij kolegji, të njëjtat pretendime kërkuari i ka ngritur edhe në ankimin përpara kësaj të fundit, ndërsa ajo, në mbështetje dhe plotësim të vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë, ka arsyetuar në mënyrë shteruese, në përputhje me nenet 380 dhe 383/1 të *KPP*-së, duke dhënë edhe arsytet përkatëse për të cilat i ka konsideruar të papranueshme pretendimet e ngritura në ankim.

5. Në datën 13.08.2024 (sipas shërbimit postar), kërkuari ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 19.09.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuarit

6. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se:

- 6.1. Akuza ndaj tij është mbështetur në aktin e referimit të veprës penale, i cili është i falsifikuar në përmbajtje për sa i përket telefonit me numër 069xxxx386, të regjistruar me emrin “Iku” në telefonin e sekuestruar shtetasit E.Z., për të cilin organi i akuzës pretendon se i është sekuestruar kërkuarit. Vendimet e gjykatave më të ulëta nuk janë bazuar në provat e shqyrtuara dhe të verifikuara në gjykim, të cilat të provojnë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuari ka kryer veprën penale, pasi nuk ekziston asnjë akt që të provojë përdorimin nga ai të këtij telefoni, nuk ka ndonjë akt për sekuestrimin e kërkuarit të këtij telefoni, ky telefon nuk ekziston si provë materiale dhe nuk ka ndonjë akt që ky telefon të jetë i regjistruar në emër të kërkuarit. Po ashtu, janë falsifikuar edhe deklaratimet e shtetasve G.D., A.Sh. dhe E.Z. përpara OPGJ-së, por edhe në gjykim. Kërkuari është deklaruar fajtor megjithëse akuza ndaj tij nuk është vërtetuar me asnjë akt dhe provë të dosjes penale, por duke u mbështetur në prova të falsifikuara.
- 6.2. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit megjithëse pretendimet e ngritura në të integrohen plotësisht me ato të parashikuara në nenin 432, pika 1, të *KPP*-së, por edhe me aktet, faktet dhe provat që ndodhen e nuk ndodhen në dosjen penale, pasi rekursi është bërë për: zbatim të gabuar të ligjit material, nenit

228, pika 1, të KPP-së, ndërsa procesi gjyqësor nuk duhet të fillonte dhe të vazhdonte; zbatim të gabuar të ligjit procedural, nenit 186 të KP-së, me pasojë pavlefshmërinë absolute të akteve, provave dhe të vendimit; mosrespektim të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 7/2011, në lidhje me nenin 228, pika 1, të KPP-së.

- 6.3. Pas përfundimit të gjykimit ka dalë një provë e re që konsiston në falsifikimin e procesverbalit të sekuestrimit të provave materiale dhe të deklarimeve të dhëna para OPGJ-së, provë e cila përmbush kriteret e nenit 450, pika 1, shkronja “c”, të KPP-së për rishikimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në rastin konkret Kolegji vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi gjyqësor i kundërshtuar prej tij, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim individual kushtetues, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në

substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 31, datë 03.11.2022; nr. 15, datë 07.05.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, se mbas përfundimit të gjykimit ka dalë një provë e re që konsiston në falsifikimin e procesverbalit të sekuestrimit të provave materiale dhe të deklarimeve të dhëna para OPGJ-së, provë e cila përmbush kriteret e nenit 450, pika 1, shkronja “c”, të KPP-së për rishikimin e vendimit të Gjykatës së Lartë. Kolegji vëren se një pretendim i tillë, në respektim të parimit të subsidiaritetit, i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme dhe vetëm pas shterimit të mjeteve juridike brenda këtij juridiksioni kërkuesi mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual në rast të cenimit të të drejtave kushtetuese. Për rrjedhojë, për këtë pretendim nuk plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike në dispozicion, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

11. Për pretendimet e tjera, Kolegji konstaton se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm, ndërsa pretendimet e ngritura në ankim i ka paraqitur më parë në substancë në këto instanca, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

12. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 25.01.2024, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 13.08.2024, sipas shërbimit postar. Me informacionin e datës 01.10.2024, Gjykata e Lartë ka sqaruar se vendimi i kundërshtuar nga kërkuesi është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 26.03.2024, datë nga e cila është bërë i disponueshëm për palët.

14. Kolegji konstaton në vijim se kërkuesi, në ankimin kushtetues individual, nuk parashtron ndonjë argument në lidhje me respektimin e afatit ligjor të paraqitjes së ankimit. Pavarësisht kësaj, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, konstatohet se kërkuesi nuk ka mbrojtës dhe se ai ndodhet i burgosur prej datës 26.02.2016. Po ashtu, konstatohet se në datën 05.06.2024 kërkuesi ka kërkuar informacion për çështjen e tij dhe Gjykata e Lartë, me shkresën

2925/1 prot., datë 06.06.2024, i ka dërguar atij vendimin nr. 00-2024-162, datë 25.01.2024 të Kolegjit Penal të saj.

15. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se fakti që kërkuesi është i izoluar për shkak të vuajtjes së dënimit me burgim, është një rrethanë që e vështirëson marrjen dijani për vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë nga njoftimi me shpallje (*shih vendimin nr. 14, datë 21.06.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Nisur nga ky standard, në kushtet kur kërkuesi është i izoluar për shkak të vuajtjes së dënimit me burgim dhe ai ka marrë dijani efektivisht për vendimin e kundërshtuar të Gjykatës së Lartë pas datës 06.06.2024, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor. Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

16. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi në ankimin e tij kushtetues individual nuk ka identifikuar në mënyrë konkrete të drejtën kushtetuese të pretenduar si të cenuar. Po ashtu, pavarësisht se në objektin e kërkesës kundërshtohet vetëm vendimi i Gjykatës së Lartë, në përmbajtjen e saj kërkuesi ka ngritur pretendime edhe për vendimet e gjykatave të zakonshme më të ulëta. Megjithatë, bazuar në parimin *jura novit curia*, referuar argumenteve të parashtruara, pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me parimin e mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, të drejtën e aksesit të lidhur me ankimin efektiv dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, të cilat bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

17. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, kërkuesi ka pretenduar se është deklaruar fajtor duke u mbështetur në prova të falsifikuara në përmbajtje, konkretisht në aktin e referimit të veprës penale dhe deklarimet e shtetasve G.D., A.Sh. dhe E.Z. përpara OPGJ-së, por edhe në gjykim.

18. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nga neni 6 i KEDNJ-së. Në këtë drejtim, detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë (*shih vendimet nr. 57, datë 21.12.2012; nr. 47, datë 07.11.2011; nr. 23, datë 23.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi bazë kushtetues që lidh provat me procesin e rregullt ligjor është i sanksionuar në nenin 32, pika 2, të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme (*shih vendimet nr. 49, datë 29.09.2014; nr. 82, datë 21.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar po ashtu se marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre është në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Gjykata mund dhe duhet

të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugën e mënyrën e marrjes dhe fiksimit të provave, por jo të vlerësimit të tyre (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 83, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material është, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme që zgjidhin çështjen konkrete dhe nuk i nënshtrohet kontrollit të saj kushtetues. Detyra e Gjykatës është që të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt. Roli i Gjykatës nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme (*shih vendimet nr. 26, datë 09.05.2014; nr. 47, datë 07.11.2011; nr. 22, datë 22.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Kolegji konstaton se pretendimi i kërkuarit, në thelb, ka të bëjë me mungesën e të provuarit të fajësisë së tij, duke e argumentuar këtë me vlerësimin e gabuar të provave të marra gjatë procesit penal, sipas tij, duke falsifikuar përmbajtjen e tyre. Nisur nga kjo, Kolegji vëren se pretendimet e kërkuarit nuk kanë të bëjnë me ligjshmërinë e marrjes së provave, por me vlerësimin e tyre nga gjykatat e zakonshme, duke e përcaktuar atë fajtor për veprën penale që akuzohet. Nisur nga kjo, duke mbajtur parasysh standardet kushtetuese si më lart, Kolegji vlerëson se kërkuari nuk ka paraqitur argumente konkrete në lidhje me cenimin e parimit të mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, për rrjedhojë ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

20. Për sa u përket pretendimeve të tjera, atij për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me ankimin efektiv dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke qenë se argumentet për këto pretendime ndërthuren, Kolegji vlerëson t'i trajtojë ato në vijim të lidhur me njëri-tjetrin.

*B. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me ankimin efektiv dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*

21. Kërkuari ka pretenduar se është deklaruar fajtor megjithëse akuza ndaj tij nuk është vërtetuar me asnjë akt dhe provë të dosjes penale. Sipas tij, vendimet e gjykatave më të ulëta nuk janë bazuar në provat e shqyrtuara dhe të verifikuara në gjykim, të cilat të provojnë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se ai ka kryer veprën penale. Akuza, sipas tij, është mbështetur në aktin e referimit të veprës penale, i cili është i falsifikuar në përmbajtje për sa i përket telefonit me numër 069xxxx386, të regjistruar me emrin "Iku" në telefonin e sekuestruar shtetasit E.Z., për të cilin organi i akuzës pretendon se i është sekuestruar kërkuarit, ndërkohë që nuk ekziston asnjë akt që të provojë përdorimin nga ai të këtij telefoni, nuk ka ndonjë akt për sekuestrimin atij të këtij telefoni, ky telefon nuk ekziston si provë materiale dhe nuk ka ndonjë akt që ky telefon të jetë i regjistruar në emër të tij. Gjithashtu, sipas kërkuarit, është falsifikuar edhe

përmbajtja e deklarimeve të shtetasve G.D., A.Sh. dhe E.Z. përpara OPGJ-së, por edhe në gjykim. Edhe Gjykata e Lartë, megjithëse pretendimet e ngritura në rekurs integrohen plotësisht me ato të parashikuara në nenin 432, pika 1, të KPP-së, por edhe me aktet, faktet dhe provat që ndodhen e nuk ndodhen në dosjen penale, ka vendosur mospranimin e tij, pavarësisht se rekursi është bërë për zbatim të gabuar të ligjit material dhe atij procedural, me pasojë pavlefshmërinë absolute të akteve, provave dhe të vendimit.

22. Në jurisprudencën e saj Gjykata e ka vlerësuar të drejtën e aksesit si një nga aspektet e së drejtës për proces të rregullt ligjor, që nënkupton të drejtën e individit jo vetëm për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe për të marrë një përgjigje përfundimtare të arsyetuar prej saj për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket së drejtës së ankimit, Gjykata e ka vlerësuar si mundësi të çdo individit për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë. Për ushtrimin efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi realizimi i saj si në aspektin formal/procedural, ashtu edhe atë substancial, ndërkohë që kërkesat procedurale të ankimit janë para së gjithash në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 23, datë 25.04.2023; nr. 24, datë 25.04.2016; nr. 14, datë 05.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në lidhje me arsyetimin e vendimeve gjyqësore, Gjykata është shprehur se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023, nr. 12, datë 19.03.2015; nr. 33, datë 08.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Për vendimet e mosprimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, Gjykata ka theksuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mosprimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket funksioneve të kolegjit të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të rekurseve në dhomën e këshillimit, Gjykata ka pohuar se në rast se kolegji krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 59, datë 23.07.2015; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).



24. Nga ana tjetër, Gjykata në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj ka pohuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi dhe zbatimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 7, datë 07.02.2017; nr. 13, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim, Kolegji konstaton se procesi gjyqësor në shkallë të parë është zhvilluar me procedurën e gjykimit të zakonshëm, ndërsa kërkuesi ka marrë pjesë rregullisht dhe është mbrojtur nga një avokat i zgjedhur, duke pasur mundësi për të paraqitur kërkesa dhe për të debatuar në lidhje me provat, si dhe për të mbajtur qëndrim rreth faktit penal dhe akuzës së atribuuar. Ndërkohë, në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket faktit penal të pranuar si i provuar, ajo gjykatë ka arsyetuar edhe sa u përket provave mbi të cilat ka arritur në atë përfundim dhe konkretisht në aktet e sekuestrimit të provës materiale (lëndës narkotike), mjetit të transportit e dokumentacionit të tij dhe të tre telefonave celularë, rezultatet e këqyrjes së këtyre të fundit dhe të dhënat e aktit të ekspertimit teknik të tyre, të dhënat e marra nga shoqëritë celulare, rezultatet e përgjimit ambiental dhe atij telefonik, dëshmitë në gjykim të shtetasve G.D., A.Sh., I.Zh. dhe V.D., por edhe deklaratimet e tyre gjatë hetimeve paraprake, deklaratimet e të pandehurve në procedimin e lidhur E.Z. dhe L.Sh., sikundër edhe deklaratimet e kërkuesit. Në analizë të këtyre provave, nga vlerësimi i tyre në tërësi dhe harmoni me njëra-tjetrën, ajo gjykatë ka konkluduar se fajësia e kërkuesit në kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Nga ana tjetër, ajo gjykatë nuk i ka gjetur bindëse deklaratimet e kërkuesit për faktet, duke vlerësuar se ato vijnë në kundërshtim të plotë me provat e tjera në gjykim.

26. Kërkuesi e ka ankimuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe çështja në vijim është gjykuar nga gjykata e apelit, përpara së cilës kërkuesi ka parashtruar pretendimet e tij, duke pasur mundësi të debatojë në lidhje me to. Ndërkohë, në vendimin e saj, gjykata e apelit, ndërsa ka vlerësuar të drejta përfundimet e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me faktin penal të provuar, i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkuesit për mosvërtetimin e fajësisë së tij në veprën penale, duke arsyetuar se nga vlerësimi në tërësi dhe harmoni i provave të marra dhe të shqyrtuara në gjykim, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm fajësia e tij. Krahas kësaj, gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje edhe pretendimit të kërkuesit për sa i përket kompetencës lëndore të gjykatave për krimet e rënda.

27. Për sa i përket procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, ai është vënë në lëvizje mbi rekursin e kërkuarit. Rekursi i paraqitur nga kërkuari i është nënshtruar shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit, gjatë të cilit Kolegji Penal i asaj gjykate ka arritur në përfundimin se rekursi nuk përmbante ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrimin se gjykatat më të ulëta provat e marra dhe të debatuar në gjykim i kanë çmuar në përputhje me njëra-tjetrën, pa mbivlerësuar asnjërën prej tyre, duke arsyetuar në lidhje me përgjegjësinë penale të kërkuarit në raport me faktin, provat dhe ligjin, ndërsa kanë arritur në të njëjtin konkluzion për sa i përket fajësisë së tij në kryerjen e veprës penale. Për sa u përket pretendimeve në lidhje me vlerësimin e provave, ajo gjykatë është shprehur se një gjë e tillë del jashtë kontrollit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Po sipas saj, nuk rezulton që nga gjykata e apelit të ketë mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk evidentohet mosrespektim ose zbatim i gabuar i ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, si dhe nuk rezulton që vendimi i gjykatës së apelit të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Krahas kësaj, Gjykata e Lartë ka trajtuar edhe pretendimin në recurs të kërkuarit për sa i përket veçimit të çështjes penale, duke mos konstatuar zbatim të gabuar të ligjit procedural penal nga gjykatat më të ulëta, sikundër edhe pretendimin për moskompetencën lëndore të gjykatave për krime e rënda, duke konsideruar si shteruese përgjigjen e dhënë nga gjykata e apelit.

28. Nisur nga sa më lart, Kolegji vëren se kërkuari ka ushtruar lirisht të drejtën e aksesit në të tria shkallët e gjykimit, duke iu garantuar atij e drejta për të paraqitur pretendime në gjykim, sikundër edhe për të paraqitur ankim në gjykatat më të larta, duke marrë përgjigje nga ato. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj ka treguar mjaftueshëm rrethanat e çështjes, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra nga ato, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ajo është bazuar për zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë. Ajo gjykatë ka vlerësuar edhe deklaratimet e kërkuarit, sikundër edhe argumentet e tij për mungesën e provave të fajësisë, por në analizë të të gjitha provave të marra dhe të shqyrtuara në gjykim ka arritur në përfundime për ekzistencën e faktit penal dhe fajësisë së tij, ku mbi këtë bazë në vijim ka zbatuar dhe ligjin penal. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe gjykata e apelit, e cila ka arsyetuar mjaftueshëm duke u dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në ankim nga kërkuari për mungesën e të provuarit të fajësisë së tij. Ndërkohë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, sipas kompetencës të përcaktuar në nenin 433 të KPP-së, ka realizuar shqyrtimin paraprak të rekursit të kërkuarit duke analizuar dhe vlerësuar nëse shkaqet e ngritura në të janë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe pasi ka arritur në përfundimin se nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji dhe nuk gjejnë

mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, në përputhje me funksionin e tij ka vendosur mospranimin e rekursit.

29. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se në procesin gjyqësor të kundërshtuar nuk duket që kërkuesit të mos i jetë garantuar e drejta e aksesit dhe ajo e ankimit efektiv dhe as se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të mos kenë përmbushur standardet kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor, për rrjedhojë pretendimi i tij në këtë drejtim është haptazi i pabazuar.

30. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.